



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 606/\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2019

**V E N D I M**

Nr. \_\_\_, Datë \_\_\_\_\_.2019

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË BERAT “MBI AUDITIMIN FINANCIAR  
DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”  
(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.09.2019)**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Berat me objekt “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë”, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Berat sipas programit të auditimit nr. 606/1 prot, datë 26.08.2019, për periudhën 01.01.2017 – 30.09.2019.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## A. OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

#### **Për drejtimin e Bashkisë Berat.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2018 të cilat përfshijnë:

1. Pasqyrën e pozicionit financiar;
2. Pasqyrën e performancës financiare;
3. Pasqyrën e flukseve monetare;
4. Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
5. Pasqyrën mbi shënimet shpjeguese si dhe pasqyrat statistikore.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi sipas parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Veprimtaria është audituar sipas kërkesave të përputhjes me parimet e kontabilitetit të pranuar ligjit organik të buxhetit, si kërkesat: e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël “Kapitulli I, pika 1 dhe UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj” Kapitulli IV “Disa veçori për llogarite vjetore të njësite të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 58,59 dhe 60 “Shërbimi i borxhit”, me ligjin nr.9869 datë 04.02.2009 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore “neni 9 pikat 2,5; neni 2 pika 4; neni 12 pika 1; me ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 41 “Buxheti i njësite të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm” pika 2 nënpika (ç/iii).

Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për opinionin tonë.

#### **Opinion i kualifikuar<sup>1</sup>:**

Sipas mendimit tonë, përveç çështjes së theksuar në paragrafin e “Bazës për Opinionin e kualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare më datë 31 dhjetor 2018, referuar ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **Baza për opinion e kualifikuar:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Berat, për vitin ushtrimor, më 31 dhjetor 2018, e cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat

<sup>1</sup> **Opinion i kualifikuar.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

Kemi konstatuar se në disa llogari të pasqyrave financiare, janë kryer veprime kontabël të gabuara duke natyruar përmbajtjen e tyre dhe duke pakësuar vlera kontabël, çka i bëjnë ato të pa sakta:

- Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera.

- Për vitin 2018, nga Drejtoria e Financës, *nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit* financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit.

Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme.

### **Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Berat<sup>2</sup>**

Ne kemi audituar përputhshmërinë<sup>3</sup> e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Berat, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2017 dhe 2018.

#### **Opinion i kualifikuar.**

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Berat, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

#### **Baza për opinionin e kualifikuar:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

- Në Bashkinë Berat, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Detyrimet e faturuara të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të

shtetit dhe të rajoneve në fund të vitit 2019 janë në vlerën **75,276,256 lekë**.

- Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë

administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

<sup>2</sup> ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

<sup>3</sup> Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

- Janë konstatuar mos pagimi në afat të detyrimit tatimore nga subjektet në Bashkinë Berat dhe 4 Njësitë Administrative më datën 30.09.2019 detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në shumën prej **267,055 mijë lekë**, debitor si më poshtë:
- 563 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh, në vlerën 68,838,416 lekë
- 10,503 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 62,813,625 lekë
- për taksën e ndërtimit, tarifatat e pastrimit në vlerën 135,403,069 lekë, nga të cilat:
- rreth 6000 familjarë në vlerën 44,944,004 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjetës sha Berat.
- 26,225,134 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë,
- 700 familjarë nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 26,225,134 lekë.

Stoku i faturave të palikuiduara paraqitet në shumën 75,276,256 lekë.

- Në fushën e të ardhurave nga taksat, tarifatat, qiradhëniet dhe gjobat u konstatuan të ardhura të munguara në shumën 176,329 mijë lekë nga të cilat: -59,300 mijë lekë, gjoba dhe kamata për mos arkëtim për ndërtimet pa leje, -26,225 mijë lekë mosarkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë për objekte që legalizohen, -75,504 mijë lekë mos lidhje kontrate për lejet minerare dhe, -15,300 mijë lekë për lejet e tregëtimit fundor të karburanteve.
- Në zbatimin e punimeve të 6 kontratave u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **15,526 mijë lekë**.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Berat.**

Drejtimi i Bashkisë Berat, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Njësia Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Berat, nuk ka audituar aktivitetin e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit dhe Policinë Bashkiake, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik “, (*Trajtuar në faqet 36-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**1.1 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Berat, të parashikojë dhe ushtrojë një auditim për aktivitetin e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit dhe Policia Bashkiake ndër të tjerat edhe administrimi i dokumentacionit të blloqeve si letra me vlerë. Gjithashtu në mbylljen e raporteve finale të auditimit, të përcaktohen masa konkrete për personat përgjegjës për veprimet apo mosveprimet në përputhje me ligjin për të cilën është konstatuar shkelja.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Sipas Informacioneve të paraqitura nga IMTV, Bashkia Berat,rezulton se në total, për periudhën e viteve 01.01.2015 deri 30.09.2019 , për ndërtime të kundërligjshme /mos zbatim të rregullave për kolaudimin dhe ndërtimet janë dënuar me Vendime për Dënim me gjobë 125 kundërvajtës, me vlerë totale 38,650,000 lekë,(të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare llogaria 468 më dt.31.12.2019 ) prej tyre deri më datën 01.11.2019, janë arkëtuar gjobat vetëm nga 17 subjekte në vlerën 2,200,000 lekë ose në masën 5.6%. Ndërkohë vetëm për 13 subjekte në vlerën 6,900,000 lekë janë kërkuar nga Gjykata e Shkallës së parë Berat, kthimi vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, por deri më datën 01.11.2019 janë kthyer në tituj ekzekutiv vetëm 4 vendime gjobe në vlerën 2,000,000 lekë, por edhe këto 4 vendime gjoba nuk janë ekzekutuar (arkëtuar), ndërsa për 6 vendime gjobe në vlerën 4,900,000 lekë, nuk është kthyer përgjigje nga Gjykata dhe nga IMTV Bashkia Berat nuk i është përsëritur kërkesa duke mbetur pezull dhe pa veprim

Pasqyrë përmbledhëse e Vendimeve të gjobave dhe arkëtimi për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019, IMT Bashkia Berat

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se nga 122 gjoba të vendosura për vlerën 38,650,000 lekë, rreth 63 % të numrit të gjobave ose 55 gjoba x 500,000 lekë dhe 81.5% të vlerës prej 31,500,000 lekë e zënë gjobat minimale prej 500,000 lekë për secilin rast.

Pra më datën 01.11.2019 për **100 vendime gjobe** nuk është vepruar duke të mbetur të pa arkëtuara vit pas viti dhe shkaktuar mungesë të ardhurash në Bashkinë Berat. **në vlerën prej 28,400,000 lekë**. (Për vendimet e 100 gjobave në vlerën prej 28,400,000 lekë nuk janë llogaritur kamat vonesat në vlerën 60 % të shumës ose 17,040,000 lekë duke shkuar vlera **prej 45,440,000 lekë** (28,400,000+ 17,040,000)

Nga auditimi rezulton se për **100 vendime gjobe në vlerën prej 28,400,000 lekë**, të vendosura për periudhën 4 vjeçare e 9 muaj respektivisht nga data 01.01.2015 deri 30.09.2019,prej tyre **31 vendime gjobe në vlerën 20,650,000 lekë**, të vendosura për **periudhën 2 vjeçare e 10 muaj**, nga data 01.01.2015 deri 31.10.2017 të cilave u ka kaluar afati 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar (pra nuk mund të vilen më) dhe asnjë nga ish kryeinspektorët e IMT pasardhës konkretisht **z.R. B. dhe z.L. S., Drejtoria Juridike Bashkia Berat** juristja e IMTV **znj. E. T.** dhe ish kryetari i Bashkisë Berat **z.P. S.**, nuk kanë ndërmarrë asnjë nga hapat ligjore/nënligjore edhe pse **u ka kaluar afasti 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar dhe nuk mund të vilen më.** (*Trajtuar në faqet 36-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**2.1 Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, Bashkia Berat,bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 31 vendime gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 01.01.2015,deri më datën 31.10.2017, për shumën **20,650,000 lekë**, (duke

llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar).

#### **Aneksi nr. 2 bashkëlidhur.**

b.Njëherazi Bashkia Berat Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrin masa për kthimin në tituj ekzekutiv të 125 vendimeve të gjobave në vlerën **38,650,000 lekë**, në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar). **Aneksi nr. 1.bashkëlidhur**

#### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Berat më datën 31.12.2018 sipas bilancit (llog. 486) paraqitet me fatura të prapambetura në shumën **39,836,177 lekë**. Gjatë 9-mujorit 2019 ka likuajduar fatura në shumën **34,807,895 lekë**, mbetur pa likuajduar fatura të palikuajduara në shumën **5,028,282 lekë** dhe vendime gjyësore në shumën **9,061,735 lekë**. Vlerën më të lartë të detyrimeve e zënë shpenzimet për energji të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, detyrim i vitit 2007 në shumën 9,294,942 lekë, detyrimet gjyqësore në shumën 5,470,961 leke, fatura nr. 7 datë 27.08.2018 e operatorit Boshnjaku B, për objektin "Ndërtim i ujësjellësit Qereshnik" me shumën 4,155,960 lekë, fatura nr.86 datë 15.10.2018 e operatorit Piennis sh.p.k me objekt "Rikonstruksion i muzeut historik Sinjë" me shumën 2,612,283 lekë, si dhe fatura të tjera të përshkruara në pasqyrën më sipër. Sic shihet dhe nga pasqyra është likuiduar 87 % e detyrimeve të prapambetura të vitit 2018. (*Trajtuar në faqet 91-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Berat (Drejtoria e Financës), bazuar ne; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pikat 82-91 "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "*Për buxhetin e vitit 2019*", pikat 106-110, "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*", dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*". të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën prej 14,090,017, nga e cila vlera e faturave të palikuajduara në shumën **5,028,282 lekë dhe vendime gjyqësore për shumën prej 9,061,735 lekë (Bashkëlidhur Aneksi nr.8 mbi gjendjen e faturave të palikuajduara me datën 30.09.2019)**

#### **Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Bashkia Berat, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë me vlerë **26,225,134 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat. (*Trajtuar në faqe 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **26,225,134 lekë**.

#### **Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e 4 Njësive administrative të Bashkisë Berat, administratorët e Njësive administrative, edhe pse nuk e kanë në kompetence kanë nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore ndaj subjekteve Juridike dhe fizike. Në kundërshtim me:

a. ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 4-Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 2, ku parashikohet se: Zyra e taksave të bashkisë apo komunës vendos e zbaton sanksione për shkelje të procedurave e të detyrimeve fiskale vendore, të përcaktuara në ligjin, nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, b. ligjin, nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 70, E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor pika 3, ku përcaktohet se: Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit, që klasifikohen si biznes i vogël. Për detyrimet tatimore, të lidhura me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatimor nxirret nga drejtoria rajonale tatimore. (Trajtuar në faqen 117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Berat në Rregulloren e Brendshme të përcaktojë për punonjësit e taksave të 4 Njësive Administrative se njoftim vlerësimet tatimore të nxiren vetëm nga Drejtoria e të Ardhurave bashkia Berat dhe jo si deri tani të cilat janë nxjerrë jashtë kompetencave nga Administratori i Njësive Administrative.

## Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Berat dhe 4 Njësiti Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore subjektet më datën 30.09.2019 Vlera e debitorëve për taksat dhe tarifrat vendore në shkallë bashkie Berat janë në shumën prej **267,055,110 lekë**, e cila përfaqëson:

- 563 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh, në vlerën 68,838,416 lekë
  - 10,503 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 62,813,625 lekë
  - Për taksën e ndërtimit, tarifrat e pastrimit në vlerën **135,403,069 lekë**, nga të cila:
    - rreth 6000 familjarë në vlerën 44,944,004 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjetllës sha Berat.
    - 26,225,134 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë,
    - 700 familjarë nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 26,225,134 lekë.
- (Trajtuar në faqen 117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore **Bashkia Berat**, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifrat vendore në vlerën **267,055,110 lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të **ndiqen rrugët e mëposhtme:**

**a)** Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

\*Nuk është vendosur masa e detyrimit tatimorë, ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1 ku thuhet: "..... nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij".

\*Nga ana e inspektorëve të Njësive Administrative Otllak, Velabisht, Sinjë, dhe Roshnik nuk është vepruar sipas ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 2. ....Masa e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësive së ngjashme me të ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore.

\*Nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, siç parashikohet në nenin 93, të ligjit 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1 ku thuhet : " Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit".

**7. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të larta, konstatohet se nga AK (Bashkia Berat), për asnjë rast nuk është bërë i mundur ngritja e KSHA(komisioni i shqyrtimit të ankesave) për ankesat e paraqitura nga OE gjatë zhvillimit të procedurave, veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP dhe neni 78 të VKM 914.

Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet e mbajtura nga NJHDT dhe KVO nuk janë protokolluar, veprim në mospërputhje me nenin 18, "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".

Pjesa më e madhe e dosjeve të audituara rezultuan se nuk ishin të inventarizuar dhe të numëruara, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 "Për Arkivat" dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 36. (*Trajtuar në faqet 148-223 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e prokurimeve të marrë masa të mosvijnë me procedurat e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga OE pa ngritur më parë KSHA si dhe nga ana e këtij të fundit të mbahen procesverbalet përkatës deri në kthimin e përgjigjes OE ankues.

-Drejtoria e prokurimeve të marrë masat e nevojshme që çdo procesverbal i mbajtur nga anëtarët e NJHDT dhe KVO-së të jetë i protokolluar.

- Nga ana e Drejtorisë së prokurimeve të merren të gjitha masat për inventarizimin e plotë të dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara.

## Menjëherë

**8. Gjetje nga auditimi:** KLSH ka dërguar në Bashkinë Berat rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. prot 1104/9 datë 14.05.2016, **si më poshtë:**

-Janë rekomanduar 14 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 2 masa, dhe zbatuar pjesërisht 7 masa dhe janë pjesërisht të zbatuara 3 masa.

-Janë rekomanduar 13 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 13 masa.

-**Shpërblim dëmi janë rekomanduar 28 masa me vlerë 55,846,909 lekë**, nga verifikimi rezultoi se deri më datë 30.09.2019, vlera debitore është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 – "Debitorë të tjerë", të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2018 (bilanci vjetor 2018) vlera prej 44,083,697 lekë.

Deri më datën 30.09.2017 është arkëtuar vlera prej 1,006,892 lekë.

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej 26,806,859 lekë nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 3 rekomandime në vlerën 81,785 lekë

-Në proces gjyqësor 10 rekomandime në vlerën 26,725,074 lekë

*Nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 55,846,909 lekë, deri më datën 30.09.2019 paraqiten:*

*-Për 28 rekomandime janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe janë arkëtuar 1,006,892 lekë në 17 raste.*

*-Janë ngritur padi Gjyqësore ndaj Bashkisë dhe janë dhënë Vendime Gjykate të Shkallës së Parë dhe të formë së prerë në favor të punonjësve dhe privatëve të ngarkuar me masa shpërblim dëmi në 65 raste në shumën 28,131,378 lekë.*



*-Nga punonjësit dhe privat të ngarkuar me masa shpërblim dëmi janë ngritur padi në Gjykatën Administrative Berat dhe janë në proces gjyqësor në 25 raste në shumën 26,479,574 lekë. (Trajtuar në faqen 254 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin e Auditimit të kryer në **Bashkinë Berat**, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 50-Auditimi i jashtëm pika 4 dhe 5 *ku përcaktohet se: Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.*

#### **Në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:

Nga ana e Bashkisë Berat në asnjë rast nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet që janë paisur me leje minerale nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullimore që administrohen nga kjo bashki.

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “B.” shpk, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1368 datë 18.06.2009, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 7 (shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “T.” shpk,, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1694 datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 (njëmbëdhjetë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,310,000 lekë

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “B.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1379 datë 03.07.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7(gjashtëmbëdhjetë.shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 20,207,000 lekë.

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “P.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1359 datë 08.06.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 11.5(njëmbëdhjetë.pesë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,915,000 lekë.

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “E.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1597 datë 19.11.2012, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 9.2(nëntë.dy) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 11,132,000lekë.

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “T.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1101 datë 06.12.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 7(shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.

Veprimi dhe mosveprimi është në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6. Në gjashtë raste sipas aneksit B/2, në vlerën **75,504,000 lekë** (Trajtuar në faqen 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**9.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Berat, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e detyrime të pa arkëtuara në vlerën **75,504,000 lekë** dhe lidhjen e kontratave me subjektet “B.” me vlerë 8,470,000 lekë, “T.” me vlerë 13,310,000 lekë , “B.” me vlerë 20,207,000 lekë, “P.me vlerë 13,915,000 lekë , “E.” me vlerë 11,132,000lekë, “T.” me vlerë 8,470,000 lekë.

## Menjëherë

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në zbatim të me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 të Bashkisë Berat, për periudhën 2017, 2018 dhe 9 muhori i vitit 2019, **konstatohet se:**

Në bashkinë Berat ushtrojnë 18 subjekte të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët në vlerën **15,300,000 lekë** sipas aneksit 1 në zbatim të pikës B/4. *(Trajtuar në faqe 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Berat të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 15,300,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, në zbatim të, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

## Menjëherë

**11. Gjetje nga auditimi:** Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura, blerje mallrash apo investimesh, nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe çeljen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyjnë pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. *(Trajtuar në faqet 67-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.

## Në vazhdimësi

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, u konstatua se mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mos efektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë rrisur dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimit shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përlllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimin e tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv. *(Trajtuar në faqet 53-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës,

përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

**Në vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2018, 2019 nga Drejtoria e Financës **nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit** financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit. Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme. (Trajtuar në faqet 53-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**13.1 Rekomandimi:** Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim:

- njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit,
- programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe
- zvogëlimin e borxhit financiar.

**Në vazhdimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga testimi i funksionimit të kontroleve të vendosura në kuadrin e menaxhimit financiar dhe kontrollit raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 40% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 49% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e njësive për periudhën 2018-2022 rreth 40% e të intervistuarve nga të cilët 25% raportojnë se strategjia është reflektuar tek buxheti vjetor, 41% tek plani strategjik dhe 9% tek përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësi; në procesin e rekrutimit janë përfshirë vetëm 40% e drejtuesve. (Trajtuar në faqet 14-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**14.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.

**Në vazhdimësi**

### **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, **nga ana e Titullarit të njësive publike (Bashkia Berat)**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,946,578 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës prokurimit me objekt “Blerje materialesh elektrike” Berat Sipas kërkesës së: Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike”, me FL në vlerën 1,636,342 lekë, OE i shpallur fitues “K.” me vlerë të ofertës 1,570,000 lekë, për të cilën është lidhur kontrata me nr. 2518 prot., datë 29.05.2017 me vlerë 1,884,000 lekë me tvsh, procedurë e cila është anuluar nga AK si pasojë e shkresës së bërë nga OE. Në zbatim të LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24, Sigurimi i kontratës, nga ana e Bashkisë Berat nuk është mbajtur sigurimi i kontratës në shumën **188,400 lekë me dëm ekonomik shkaktuar në buxhetin e Bashkisë Berat**. (Trajtuar në faqen 170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1. Rekomandim:** Bashkia Berat, drejtoria e financës, të marë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore arkëtimin e shumës **188,400 lekë** si sigurim kontrate OE “K.”

SHPK të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materialesh elektrike”, bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24.

#### Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat”, Bashkia Berat**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 14,983,653 lekë, fituar nga OE “B.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 211,888 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 3080 prot datë 04.07.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe OE “Boshnjaku B” Shpk. *(Trajtuar në faqen 238 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **211,888 lekë pa tvsh** nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 3080 prot datë 04.07.2017, me objekt “Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat”, Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

#### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës”, Bashkia Berat**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 48,850,889 lekë, fituar nga OE “B.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 464,600 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 5893 prot datë 28.10.2016, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe OE “Boshnjaku B” SHPK. *(Trajtuar në faqen 240 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **464,600 lekë pa tvsh** nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5893 prot datë 28.10.2016, me objekt “Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës”, Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

#### Menjëherë

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho”, Bashkia Berat**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 312,462,933 lekë dhe kontratës me objekt “Shtesë kontrate për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho”, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me tvsh) 46,412,975 lekë, fituar nga BOE “G.” shpk & “B.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën totale 6,482,720 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e sipërmarrjes së punimeve, përkatësisht Nr. 5893 prot datë 28.10.2016 dhe Nr. 6015 prot, datë 29.12.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe BOE “G.” shpk & “B.” SHPK. *(Trajtuar në faqen 244 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **6,482,720 lekë pa tvsh** nga BOE “G.” shpk & “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratat me Nr. 5893 prot datë 28.10.2016 dhe Nr. 6015 prot, datë 29.12.2017, përkatësisht me objekt “Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës”, Bashkia Berat dhe “Shtesë kontrate për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho”, Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

#### Menjëherë

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re”, Bashkia Berat**, me vlerë të kontratës 78,347,107 lekë

me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “L.” SHPK & “S.” SHPK & “E.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Prishje suvatime tavani”; “Suvatim solete”; “Lyrje me bojë hidroplastike Importi cilësi e I-rë” duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **583,470 lekë** me TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat dhe sipërmarrësit Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “L.SHPK & “S.” SHPK & “E.” SHPK. *(Trajtuar në faqen 248 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Berat, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **583,470 lekë** pa TVSH nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “L.” SHPK & “S.” SHPK & “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, për kryerjen e punimeve me objekt “Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re”, Bashkia Berat, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme Starovë”, *Bashkia Berat*, me vlerë të kontratës 52,263,124 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “T.” SHPK & “B.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “F.V kasete llamarine xingat”; “Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm; “Shtresë jastek gome me t=3 cm”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **1,015,500 lekë me TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3082 prot, datë 28.07.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat dhe sipërmarrësit Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “L.” SHPK & “S.” SHPK & “E.” SHPK. *(Trajtuar në faqen 250 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1. Rekomandim:** Të merren masa nga Bashkia Berat, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “T.” SHPK & “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **1,015,500 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Berat, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

**Menjëherë**

## **C/I. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitet 2017-2018 dhe 9 mujorin e vitit 2019, janë konstatuar 11 procedura me shkelje, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **19,171,364 lekë** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative:

**C.I.1. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt “Rikonstruksion i fasadave të ndërtesave të banimit dhe stadiumit “Tomorri”, në bulevardin Republika”, me FL në vlerën 72,480,695 lekë, OE i shpallur fitues “Z.” SHPK me vlerë të ofertës 70,247,274 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. Duke kualifikuar OE “Z.” shpk me ofertë 70,247,274 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **2,921,952 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe

asaj më të ulët të ofruar nga OE “B.” shpk në vlerën 67,325,322 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**C.I.2. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt “**Rikonstruksion i Muzeut Historik Sinjë**”, me FL në vlerën 8,446,819 lekë, OE i shpallur fitues “P.” me vlerë të ofertës 7,634,330 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”. Duke kualifikuar OE “P.” shpk me ofertë 7,634,330 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,677,352 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE “C.” shpk në vlerën 5,956,978 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**C.I.3. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt “**Blerje karburanti për Bashkinë Berat dhe për drejtori**”, me FL në vlerën 13,190,550 lekë, OE i shpallur fitues “P.” me vlerë të ofertës 13,127,576 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”. Duke kualifikuar OE “P.” shpk me ofertë 13,127,576 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,445,678 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE “A.” shpk në vlerën 11,681,898 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**C.I.4. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt “**Restaurim i mureve të Kalasë Berat**”, me FL në vlerën 7,676,667 lekë, OE i shpallur fitues “M.” me vlerë të ofertës 6,826,124 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”. Duke kualifikuar OE “M.” shpk me ofertë 6,826,124 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **514,569 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE “C.” shpk në vlerën 6,311,555 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**C.I.5. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt “**Mirëmbajtje kanale ujitëse dhe kulluese**”, me FL në vlerën 3,801,667 lekë, OE i shpallur fitues “S.” me vlerë të ofertës 2,965,565 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anulon*

*procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*". Duke kualifikuar OE "S." shpk me ofertë 2,965,565 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **359,087 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "A." shpk në vlerën 2,606,478 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**C.I.6. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "**Rikonstruksion i repartit të pediatriisë në spitalin e Beratit**", me FL në vlerën 12,452,108 lekë, BOE i shpallur fitues "B." & "Sh." shpk me vlerë të ofertës 9,638,841 **lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*". Duke kualifikuar BOE "B." & "Sh." shpk me ofertë 9,638,841 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **180,596 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C." shpk në vlerën 9,458,245 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**C.I.7. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "**Rikonstruksion i fasadave në lagjen Murad Çelebiu**", me FL në vlerën 37,589,184 lekë, BOE i shpallur fitues "S." & "M." shpk me vlerë të ofertës 37,024,857 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*". Duke kualifikuar BOE "S." & "M." shpk me ofertë 37,024,857 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **8,822,789 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C.i" shpk në vlerën 28,202,068 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**C.I.8. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "**Rikonstruksion i çerdhes Uznovë**", me FL në vlerën 7,076,528 lekë, OE i shpallur fitues "B." shpk me vlerë të ofertës 5,101,460 lekë. KVO ka s'kualifikuar OE "C." shpk me ofertë në vlerën 5,056,846 e cili plotësonte të gjitha kriteret e vendosura nga NJP. Duke shpallur fitues OE "B." shpk me ofertë 5,101,460 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **44,614 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C." shpk në vlerën 5,056,846 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**C.I.9. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "**Mirëmbajtje ujësjellës, rikonstruksion i linjës së ujësjellësit Kostren 1 dhe veprës së marrjes**", me FL në vlerën 4,166,588 lekë, OE i shpallur fitues "Z." shpk me vlerë të ofertës 4,134,613 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos

kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. Duke kualifikuar BOE “Z.” shpk me ofertë 4,166,588 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **458,788 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE “Sh.” shpk në vlerën 3,675,824 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**C.I.10. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt “Sistemi i kondicionimit për godinën e Bashkisë Berat”, me FL në vlerën 18,333,332 lekë, OE i shpallur fitues “L.” shpk me vlerë të ofertës 17,964,893 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. Duke kualifikuar BOE “L.” shpk me ofertë 17,964,893 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,293,393 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE “M.” shpk & “Boshnjaku B” shpk në vlerën 16,671,500 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**C.I.11. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit të vitit 2019 me objekt “Ujësjellësi fshati Mbreshtan, Njësia Administrative Sinjë”, me FL në vlerën 31,065,619 lekë, OE i shpallur fitues “F.” shpk me vlerë të ofertës 21,956,747 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”. Duke kualifikuar BOE “F.” shpk me ofertë 21,956,747 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,452,546 lekë**, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE “K.” shpk në vlerën 20,504,201 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Trajtuar në faqet 147-238 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**C.I.(1-11)1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, për gjetjet e më sipërme, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën totale **19,171,364 lekë pa tvsh** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

**Brenda datës 31.03.2020**

## **C.II. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

Nga auditimi u konstatuan të ardhura të munguara në shumën 404,506,500 lekë në fushën e të ardhurave, si më poshtë:



**C.II.1. Gjetje nga auditimi:** Sipas Informacioneve të paraqitura nga IMTV, Bashkia Berat, rezulton se në total, për periudhën e viteve 01.01.2015 deri 30.09.2019, për ndërtime të kundërligjshme /mos zbatim të rregullave për kolaudimin dhe ndërtimet janë dënuar me Vendime për Dënim me gjobë 125 kundërvajtës, me vlerë totale 38,650,000 lekë, (të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare llogaria 468 më dt.31.12.2019) prej tyre deri më datën 01.11.2019, janë arkëtuar gjobat vetëm nga 17 subjekte në vlerën 2,200,000 lekë ose në masën 5.6%. Ndërkohë vetëm për 13 subjekte në vlerën 6,900,000 lekë janë kërkuar nga Gjykata e Shkallës së parë Berat, kthimi vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, por deri më datën 01.11.2019 janë kthyer në tituj ekzekutiv vetëm 4 vendime gjobe në vlerën 2,000,000 lekë, por edhe këto 4 vendime gjoba nuk janë ekzekutuar (arkëtuar), ndërsa për 6 vendime gjobe në vlerën 4,900,000 lekë, nuk është kthyer përgjigje nga Gjykata dhe nga IMTV Bashkia Berat nuk i është përsëritur kërkesa duke mbetur pezull dhe pa veprim

Pasqyrë përmbledhëse e Vendimeve të gjobave dhe arkëtimi për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019, IMT Bashkia Berat

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se nga 122 gjoba të vendosura për vlerën 38,650,000 lekë, rreth 63 % të numrit të gjobave ose 55 gjoba x 500,000 lekë dhe 81.5% të vlerës prej 31,500,000 lekë e zënë gjobat minimale prej 500,000 lekë për secilin rast.

Pra më datën 01.11.2019 për **100 vendime gjobe** nuk është vepruar duke të mbetur të pa arkëtuara vit pas viti dhe shkaktuar mungesë të ardhurash në Bashkinë Berat. **në vlerën prej 28,400,000 lekë**. (Për vendimet e 100 gjobave në vlerën prej 28,400,000 lekë nuk janë llogaritur kamat vonesat në vlerën 60 % të shumës ose 17,040,000 lekë duke shkuar vlera **prej 45,440,000 lekë** (28,400,000+ 17,040,000)

Nga auditimi rezulton se për **100 vendime gjobe në vlerën prej 28,400,000 lekë**, të vendosura për periudhën 4 vjeçare e 9 muaj respektivisht nga data 01.01.2015 deri 30.09.2019, prej tyre **31 vendime gjobe në vlerën 20,650,000 lekë**, të vendosura për **periudhën 2 vjeçare e 10 muaj**, nga data 01.01.2015 deri 31.10.2017 të cilave u ka kaluar afati 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar (pra nuk mund të vilen më) dhe asnjë nga ish kryeinspektorët e IMT pasardhës konkretisht **z.R. B. dhe z.L. S., Drejtorja Juridike Bashkia Berat** juristja e IMTV **znj. E. T.** dhe ish kryetari i Bashkisë Berat **z.P. S.**, nuk kanë ndërmarrë asnjë nga hapat ligjore/nënligjore edhe pse **u ka kaluar afati 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar dhe nuk mund të vilen më.** (Trajtuar në faqet 36-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**C.II.1. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtorja Juridike, Bashkia Berat, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 31 vendime gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 01.01.2015, deri më datën 31.10.2017, për shumën **20,650,000 lekë**, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar).

#### **Aneksi nr. 2 bashkëlidhur.**

b.Njëherazi Bashkia Berat Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtorja Juridike të marrin masa për kthimin në tituj ekzekutiv të 125 vendimeve të gjobave në vlerën **38,650,000 lekë**, në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar). **Aneksi nr. 1.bashkëlidhur**

#### **Menjëherë**

**C.II.2. Gjetje nga auditimi:** Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Bashkia Berat, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksat e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezultoni se nuk kanë bërë pagesën e taksës

së ndikimit në infrastrukturë me vlerë **26,225,134 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat. (Trajtuar në faqe 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**C.II.2. Rekomandimi:** Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **26,225,134 lekë**.

#### Menjëherë

**C.II.3. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Berat dhe 4 Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore subjektet më datën 30.09.2019 *Vlera e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore në shkallë bashkie Berat janë në shumën prej 267,055,110 lekë, e cila përfaqëson:*

- 563 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh, në vlerën 68,838,416 lekë
  - 10,503 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 62,813,625 lekë
  - Për taksën e ndërtimit, tarifave e pastrimit në vlerën **135,403,069 lekë**, nga të cila:
    - rreth 6000 familjarë në vlerën 44,944,004 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjetës sha Berat.
    - 26,225,134 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë,
    - 700 familjarë nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 26,225,134 lekë.
- (Trajtuar në faqen 117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**C.II.3. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore **Bashkia Berat**, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **267,055,110 lekë**.

**C.II.4. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:

Nga ana e Bashkisë Berat në asnjë rast nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet që janë paisur me leje minerale nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullimore që administrohen nga kjo bashki.

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “B.” shpk., pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1368 datë 18.06.2009, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 7 (shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “T.” shpk., pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1694 datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 (njëmbëdhjetë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,310,000 lekë
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “B.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1379 datë 03.07.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7(gjashtëmbëdhjetë.shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 20,207,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “P.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1359 datë 08.06.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 11.5(njëmbëdhjetë.pesë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,915,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “E.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1597 datë 19.11.2012, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 9.2(nëntë.dy) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 11,132,000lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “T.” shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1101 datë 06.12.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 7(shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.

Veprimi dhe mosveprimi është në shkelje të VKM nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6. Në gjashtë raste

sipas aneksit B/2, në vlerën **75,504,000 lekë** (*Trajtuar në faqen 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**C.II.4. Rekomandimi:** Nga Bashkia Berat, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e detyrime të pa arkëtuara në vlerën **75,504,000 lekë** dhe lidhjen e kontratave me subjektet “B.” me vlerë 8,470,000 lekë, “T.” me vlerë 13,310,000 lekë, “B.” me vlerë 20,207,000 lekë, “P.” me vlerë 13,915,000 lekë, “E.” me vlerë 11,132,000lekë, “T.” me vlerë 8,470,000 lekë.

#### **Menjëherë**

**C.II.5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në zbatim të me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 të Bashkisë Berat, për periudhën 2017, 2018 dhe 9 muhori i vitit 2019, **konstatohet se:**

Në bashkinë Berat ushtrojnë 18 subjekte të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët në vlerën **15,300,000 lekë** sipas aneksit 1 në zbatim të pikës B/4. (*Trajtuar në faqe 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**C.II.5. Rekomandimi:** Bashkia Berat të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 15,300,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, në zbatim të, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

#### **Menjëherë**

### **D. MASA DISIPLINORE:**

#### **Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe me kontratë pune.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; gerrat (b, c, ç) e nenin 58-“*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9- “*Masa disiplinore*”, të kontratës individuale, dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Berat që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.**

### **E. MASA ADMINISTRATIVE:**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Berat t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për një mbikëqyrës dhe dy kolaudatorë punimesh, si më poshtë:**

**1. Ing. E. N.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin **“Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës”**, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me tvsh) 48,850,889 lekë, fituar nga OE “B.” SHPK, ku rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 464,600 lekë pa tvsh, si dhe në objektin **“Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho”**, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me tvsh) 312,462,933 lekë dhe kontratës me objekt **“Shtesë kontrate për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho”**, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me tvsh) 46,412,975 lekë, fituar nga BOE “G.” shpk & “B.” SHPK, ku rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën totale **6,482,720** lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**2. Ing. N. M.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin **“Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho”**, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me tvsh) 312,462,933 lekë, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4,616,180 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara, por të pakryera në fakt.

**3. Ing. V. T.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin **“Shtesë kontrate në objektin “Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho”**, Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me tvsh) 46,412,975 lekë, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,866,540 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara, por të pakryera në fakt.

**F. Propozim APP-së për përjashtim nga procedurat e prokurimit publik për 1 OE** për tenderin me objekt: **“Blerje materialesh elektrike”** Berat Sipas kërkesës së: Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike” me vlerë të fondit limit 1,636,342 lekë dhe shpallur fitues OE “K.” me vlerë të ofertës 1,570,000 lekë, për të cilën është lidhur kontrata me nr. 2518 prot., datë 29.05.2017 me vlerë 1,884,000 lekë me tvsh, me arsyetimin:

Si rezultat i mosparaqitjes së mallrave sipas kushteve të vendosura nga NJHT bazuar:

a. Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për prokurimin publik i ndryshuar”** konkretisht: - nenit 13- Agjencia e Prokurimit Publik ku përcaktohet se: *Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për*

- pika 3ç – ***mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike***, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit

Bashkia Berat ka dërguar shkresa me nr. 3226 prot., datë 17.07.2017 pranë APP-së ku është vënë në djeni për mospërmbushjen e detyrimit kontraktual nga ana e OE “K.” për sjelljen e mallrave të tenderuar. Bashkia Berat i ka kërkuar APP-së të marri masat përkatëse në lidhje me këtë OE. App-ja deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk ka marë asnjë masë për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LPP për përjashtim nga procedurat e prokurimit shoqërinë “K.”.

## **G. SHËNIM I KRYETARIT**

Grupi i auditimit duhet të ishte treguar më i vëmendshëm në përzgjedhjen e propozimit për masa disiplinore të nëpunësve konkretë dhe në trajtimin e të ardhurave të munguara.

**H.** Për shkeljet e konstatuara në pikat C.I.2, C.I.3, C.I.4 C.I.6 do të informohet Institucioni që ka përcjellë informacionin në KLSH me nr. 705, datë 22.06.2017.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**